



Shërbimi Mjekësor Kantonal

Deri te prindërit e nxënësve të
shkollave Primare

Schaffhausen, 7. qershor 2021

Testim i rregullt në shkollat fillore

Të nderuar prindër dhe kujdestarë ligjorë

Në shkollat Sekondare I dhe II pas pushimit pranveror u zbatua me sukses testimi i rregullt, me anë të pështymës. Ky lloj i testimit të rregullt u përdor dy javët e fundit në formë të një projekti pilot edhe në shkollën fillore si dhe në parashkollën e Dörflingen-it. Gjatë këtij projekti patëm mundësi që të kontrollojmë proceset dhe t'i përshtasim sipas nevojës së klasave fillore. Projekti pilot tregoi që testimi i rregullt është i realizueshëm edhe te nxënësit e klasave të ulta dhe se përpjekjet e shkollës janë të menaxhueshme.

Duke u bazuar në këtë përvojë pozitive dhe duke marrë parasysh mundësinë e shpërndarjes së virusit nëpër shkollat-edhe përkundër rënies së numrit të rasteve-, këshilli qeveritar vendosi që shkollat fillore duhet të jenë të përgaditura dhe të organizuara në mënyrë administrative për zbatimin e testimit të rregullt. Kështu fal përgaditjes organizative dhe administrative, Kantoni do të jetë i gatshëm në rast të përkeqësimit të gjendjes së përgjithshme dhe do të ketë mundësinë e zbatimit të menjëhershëm të testimit të rregullt në të gjitha shkollat fillore. Nëqoftëse në një shkollë paraqiten më shumë raste, këto teste mund ti shërbejn Shërbimit mjekësor Kantonal si instrument shtesë menaxhimi përkrahë testimeve të provuara deri më tani. Këto testime kryhen në vend dhe kohë të kufizuar.

Përveç kësaj Autoritetet Shkollore kanë mundësi që të kryejnë testimin e rregullt si masë parandaluse në shkollat e tyre, pa patur akoma ndonjë rast pozitiv, dhe për këtë mund të aplikojnë te Shërbimi mjekësor Kantonal.

Gjatë testimit të rregullt nxënësit duhet një herë në javë në klasë të japin sekret të pështymës (jo bris nga hunda dhe fyti). Sekreti i pështymës përzihet (në një të ashtuquajtur Pool nga 10

prova) në një provë të përbashkët. Ky proces kryhet në shkollë nga një person përgjegjës për të. Nëqoftëse rezultati i Pool-it(përzierjes) del pozitiv, duhet më pas të testohen një nga një për të gjetur se kush është i infektuar. Për këtë do të thirren ato nxënës dhe nxënëse nga Pool-i pozitiv dhe do t'ju bëhet PCR-testi individualisht. Fëmijëve nën moshën12-vjetçare, testi ju bëhet me atë të pështymës. Fëmijët një orë para testimit duhet të mos kenë ngrënë dhe të mos kenë pirë. Fëmijët nga mosha 12 vjetçare mund të vendosin, nëse duan të testohen me anë të pështymës ose me marjen e brisit nga hunda dhe fyti. Ndërsa në të dy rastet analiza laboratorik kryhet me anë të procedurës së PCR-it.

Mësimi do të vazhdojë të mbahet në klasë edhe pas një Pool-i pozitiv. Mirëpo klasa do të izolohet nga klasat tjera aq sa është e mundur. Nxënësit dhe nxënëset nga klasa e katërt do mbajnë maska mbrojtëse deri sa të vijjnë rezultatet. Sapo të përfundojë procesi, i cili zakonisht zgjatë 48 orë, guxojnë t'i kthehen mësimit normal. Ata nxënës dhe nxënëse që nuk kanë marrë pjesë në testimin e rregullt dhe as në testimin pasues individual të PCR-it, dhe si pasoj nuk mund të dëshmojnë asnjë rezultat, pozitiv ose negativ, edhe ato duhet të hynë në karantin. Karantina mund të largohet menjëherë vetëm me një test negativ të PCR-it, i cili duhet të organizohet nga vetë prindërit e nxënësve.

Në faqen e internetit www.sh.ch/corona nën rubrikën «[Alles rund ums Testen](#)» do të gjeni informata dhe dokumente rreth procedurës së testimit të rregullt. Nxënësit dhe nxënëset do të informohen më detalisht për procedurën gjatë orës mësimore. Përveç kësajë drejtori i shkollës është i gatshëm t'ju përgjigjet çdo pyetje që ju keni.



Ne do të ishim mirënjohës, nëqoftëse ju do të na jepnit pëlqimin tuaj që fëmia juaj të mund të marrë pjesë në testimin e rregullt dhe në këtë mënyrë do të solidarizoheni me nxënësit dhe nxënëset si dhe me arsimtarët. Ju lutemi plotësoni formularin e bashkangjitur në vijim dhe jepjani fmijës suaj të premtën, 11 qershor 2021, për në shkollë.

Ju faleminderit për zëmërisht për mbështetjen tuaj!

Me respekt

Dr. med. Elke Lenz-Agnes
Zëvendësja e shërbimit mjekësor
kantonal